



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A.

Nr. 406 prot.

Tiranë, më 25.02.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Kërkuesit: NEWS 24/Vetting

Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën për informacion, rregjistruar me numër rendor. 2, datë 17.02.2025, Ju informojmë se:

1. Në përgjigje të kërkesës dërguar nga ana Juaj në lidhje me pikën nr.1 **“Në datën 30.05.2024 keni njoftuar tenderin për Mirëmbajtje të sistemeve Eterna dhe komponentëve të saj për 2 (dy) vite. Kush është kompania fituese dhe a ka pasur ankesa nga kompanite konkurente?”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), “Posta Shqiptare” Sh.A. më datë 09.08.2024, ora 10:00 ka zhvilluar procedurën e prokurimit Nr. 10 datë 27.05.2024 me objekt: “Mirëmbajtje të sistemeve Eterna dhe komponentëve të saj për 2 (dy) vite”, me fond limit 50,000,000 (pesëdhjetë milion) lekë pa TVSH., të vëna në dispozicion nga të ardhurat e Shoqërisë “Posta Shqiptare” Sh.A., me procedurë “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me mjete elektronike. Kompania fituese e kësaj procedure prokurimi është operatori ekonomik **“Helius Systems”** me Nipt K91607030D.

Brenda afateve ligjore për ankesa, asnjë nga operatorët ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk ka paraqitur kundërshtime. Si rezultat Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” Sh.A., ka përgatitur formularin e Njoftimit të fituesit (në përfundim të afateve të ankimit) duke shpallur fitues operatorin ekonomik **“Helius Systems”** me Nipt K91607030D.

2. Në përgjigje të kërkesës dërguar nga ana Juaj në lidhje me pikën nr.2 **“Cila është arsyeja e skualifikimit të kompanive?”**

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët e mëposhtëm;

- Operatori ekonomik **“MC Networking”** me Nipt K722230070 me vlerë të ofertës 42.501.000 (dyzet e dy milion e pesëqind e një mijë) lekë pa TVSH.
- Operatori ekonomik **“Helius Systems”** me Nipt K91607030D me vlerë të ofertës 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë pa TVSH.
- Operatori ekonomik **“Advance Bussines Solutions - ABS”** me Nipt K21710002J, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokument tekniko ligjor.

Arsyeja e skulifikimit bazuar sipas procesverbalit të vlerësimit të ofertave, mbi plotësimin e kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në datën 20.08.2024 komisioni i vlerësimit të ofertave i bëri kërkesë në sistemin elektronik të APP-së si dhe në rrugë postare operatorëve ekonomik “Helius System” sh.p.k. me shkresën Nr.1710 prot., datë 20.08.2024 dhe “MC Networking” sh.p.k. me shkresën Nr.1716 prot., datë 20.08.2024, se sipas pikës 2.3.4. të DST-së shtojca 8 (modifikuar) gjatë fazës së vlerësimit të ofertave duhet të demonstrojë realizimin me sukses të disa detyrave për mirëmbajtjen e sistemit Eterna pjesë e Kriterëve të veçanta për kualifikim të dokumentave standarte të tenderit, që do ti vendoset në dizpozicion nga KVO-ja.

Për sa më sipër, jeni të lutur të paraqiteni pranë Autoritetit Kontraktor “Posta Shqiptare” Sh.A., Adr.: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, për të realizuar testimin e kriterit për përmbushjen e tij. Testimet do të realizohen në ambientet e “Postës Shqiptare” dhe me burimet që “Posta Shqiptare” ka në dispozicion për të realizuar këtë procedure. Detyrat e testimit do t’ju bëhen të ditura në momentin që do të paraqiteni pranë ambienteve tona, brenda 3 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në datën 22.08.2024 operatori “Helius System” sh.p.k., nëpërmjet sistemit elektronik të APP-së ka depozituar një kthim përgjigje ku na është bërë e ditur se do të vijojnë me demonstrimin dhe realizimin e detyrave për mirëmbajtjen e sistemit Eterna pjesë e Specifikimeve Teknike të Shtojca 8, të DST-së, që do ti vendoset në dizpozicion nga KVO-ja, referuar pikës 2.3.4. të DST-së. Po në datën 22.08.2024 operatori “Helius System” sh.p.k. u paraqit pranë zyrave të “Posta Shqiptare” Sh.A. për të marrë në dorëzim dokumentacionin me detyrat që janë ngarkuar nga KVO-ja për realizimin e testimit për mirëmbajtjen e sistemit Eterna. Me shkresën Nr.110/20 prot., datë 22.08.2024 u caktua që demonstrimi dhe realizimi i këtyre detyrave të mbahet pranë ambienteve të “Posta Shqiptare” sh.a., brenda datës 27.08.2024. Më datë 26.08.2024, në prani të përfaqësuesëve të kompanisë Helius System sh.p.k., dhe anëtarëve të KVO, u bë testimi i detyrave të lëna nga procesverbali i datës 22.08.2024, ku dhe u mbajt procesverbali Nr.110/21 prot., datë 26.08.2024, proces i cili përfundoi në realizimin me sukses të detyrave të ngarkuara nga KVO.

Operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k. nuk ju përgjigj kërkesës për realizim të detyrave të KVO-së as në mënyrë elektronike dhe as në mënyrë postare. Duke qenë përpara faktit se ky operator nuk përmbush plotësisht kriteret ligjore dhe teknike për kualifikim, operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k., u skualifikua nga KVO-ja.

3. Në përgjigje të kërkesës dërguar nga ana Juaj në lidhje me pikën nr.3 “Cilat ishin kriteret specifike, a u cënua konkurenca?”

Kriteret për kualifikim janë hartuar në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Kriteret e veçanta (specifike) të kësaj procedure prokurimi sipas shtojcës 8, të DST-së:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore financiare të 3 (tre) viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 99% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 99% evlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës **së fondit limit që prokurohet**

a) Në rastin e përvojës së mëparshëm nga një ent publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuar nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar jo më pak se **4 (katër)** punonjës të çertifikuar nga Microsoft për zhvillimin e aplikacioneve ose ekuivalente, të cilët të jenë të përfshirë në listë pagesat e sigurimeve shoqërore sipas formatit E-sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore dhe të ardhurat nga punësimi për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik gjatë fazës së vlerësimit të ofertave duhet të demonstrojë realizimin me sukses të disa detyrave për mirëmbajtjen e sistemit Eterna pjesë e Specifikimeve Teknike të Shtojca 5, të DST-së, që do të vendoset në dizpozicion nga KVO-ja.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Autoriteti Kontraktor "Posta Shqiptare" Sh.A., harton DST në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (e ndryshuar), për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

4. Në përgjigje të kërkesës dërguar nga ana Juaj në lidhje me pikën nr.4 **"Cila është arsyeja që Posta Shqiptare nuk depoziton pasqyrat financiare vjetore që është detyrim ligjor. Cili është qëndrimi juaj për këtë problem?"**

Shoqëria "Posta Shqiptare" Sh.a në zbatim të ligjit nr.10296 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", si dhe akteve ligjore ka depozituar Pasqyrat Financiare të vitit 2023, pranë Ministrisë Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit në cilesinë e aksionarit për dhënien e miratimit. Me marrjen e miratimit nga MEKI procedohet në pasqyrimin e tyre në portalin e-albania.

- 5 Në përgjigje të kërkesës dërguar nga ana Juaj në lidhje me pikën nr.5 **"Sa janë fitimet për vitin 2024?"**

Për vitin ushtrimor 2024 Shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a., bazuar në raportimet paraprake statistikore, rezultati financiar bruto paraqitet 4.5 herë më i ulët nga sa është miratuar në programin ekonomik-financiar.

Aktualisht jemi në fazën fillestare të hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2024 dhe njëkohesisht në proces auditimi nga audituesit ligjor.

- 6 Në përgjigje të kërkesës dërguar nga ana Juaj në lidhje me pikën nr.6 **"Sa janë xhirot vjetore për 2024?"**

Posta Shqiptare sh.a., për vitin 2024, ka realizuar xhiro vjetore në vlerë 3,375 ml lekë, e cila përfshin shitjet e realizuara nga shërbimet postare, shërbime postare ndermjet administrative nderkombetare, financiare, biznesi, shitje filatelike pulla etj.

7. Në përgjigje të kërkesës dërguar nga ana Juaj në lidhje me pikën nr.7 **"Sa përqind e buxhetit tuaj shkojnë për Prokurimet Publike?"**

Posta Shqiptare sha., për kryerjen e aktivitetit të saj bazuar në kërkesat e Filialeve parashikon çdo vit kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve të cilat ndryshojnë nga viti në vit në bazë të mundësive financiare që ka Shoqëria.

Për vitin ushtrimor 2024 rreth 20% e buxhetit shkon për Prokurimet Publike.

8. Në përgjigje të kërkesës dërguar nga ana Juaj në lidhje me pikën nr.8 **"Sa është fitimi që keni marrë nga kompania Albtelekom ?"**

Ju bëjmë me dije se Shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a., nuk ka përfituar asnjë herë nga fitimet e kompanisë "Albtelekom" vërtetuar kjo dhe në bilancet e Shoqërisë "Posta Shqiptare".

Duke Ju falenderuar,



ADMINISTRATOR

Ardit Demiri